

VENDIM
Nr.253, datë 27.4.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.766, DATË 8.12.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGESËN E PUNONJËSVE TË DISA LINJAVE TEKNOLOGJIKE
USHTARAKE TË RËNDËSISË SË VEÇANTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.766, datë 8.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e dytë të pikës 1, afati “...deri më 31.12.2005” zëvendësohet me “...deri më 30.6.2006.”.

b) Në fund të pikës 4, viti “...2005” zëvendësohet me “...2006”.

2. Fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Pagesë papunësie”, miratuar për Ministrinë e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha